

# Cilën rrugë duhet marrë?

Navigatori i Maturës, ju ndihmon të orientoheni në aspektin e shumëllojshmërisë të shkollave të maturës për arsimim të mëtejme.



Gymnasium



Berufsmaturität



FMS



WMS



IMS

## Gjimnazi

(Gymnasium)

Rruga e drejtpërdrejtë për studime në një universitet gjegjësisht në një shkollë të lartë dhe parakusht i shkëlqyeshëm për të marrë përsipër detyra të sofistikuar në shoqëri: asnjë shkollim tjetër nuk mundëson njëkohësisht preokupim me **një spektër të gjerë** të temave dhe një thellimi të krahasueshëm profesional. Ky shkollim i përgjithshëm i shumanshëm dhe gjithëpërfshirës ju aftëson për të **marrë një studim shkencor të cilit do drejtim**. Gjimnazi ju kualifikon edhe për një arsimim në një shkollë të lartë profesionale.




### Moritz

Gjimnazi, Drejtimi i studimit Fizikë dhe Aplikimet e Matematikës  
 «Nuk ka rëndësi a është matematika apo fizika, në këto lëndë kryesore trajtohen tema interesante dhe patjetër shuhet etja ime për dituri në fushën e teknike! Gjimnazi kantonal më ofron një spektër të gjerë të njohurive themelore, kjo më përgatit shumë mirë për shkollat e mëtejme.»

## Matura profesionale

(Berufsmaturität, BM)

Një formim profesional solid dhe praktik, si dhe një arsim i përgjithshëm i zgjeruar, karakterizojnë pjekurinë apo maturën profesionale. Kjo mund të arrihet gjatë **mësimit të profesionit (BM 1)** ose më vonë në **rrugën e sytë arsimore (BM2)**. Matura e profesionit garanton qasje **pa provim pranues në të gjitha shkollat e larta profesionale**. Pas mbarimit me sukses të provimit për «Passarelle» matura profesionale mundëson qasjen në një universitet gjegjësisht në një studim në shkollë të lartë. Qasja në shkollat e larta pedagogjike është e mundshme edhe me anë të një kursi paraprak për shkollë të lartë pedagogjike.



### Noemi

Matura profesionale BM 1, Drejtimi TALS  
 «Një e ardhme në profesion për mua është shumë me rëndësi. Me maturë profesionale më hapen të gjitha rrugët e shkollimit të mëtejme.»

## Shkolla e mesme e profesionit

(Fachmittelschule, FMS)

Shkolla e mesme profesionale përgatitë qëllimshëm dhe në mënyrë themelore dhe optimale për profesione me kërkesat e shtuara në fushat profesionale **shëndetësi, shoqërore, pedagogjike, dizajn si dhe komunikim dhe informim** – për shkollimit në njërin nga shkollat e larta profesionale, në një shkollë të lartë pedagogjike, në një shkollë të lartë të artit ose në një shkollë të lartë profesionale. Pas tri vitesh, shkolla e mesme profesionale përfundohet me një **Certifikatë të njohur zvicerane të shkollës së mesme profesionale** dhe pas katër viteve me **maturë profesionale në degën e zgjedhur të profesionit**.

### Diana

WMS-S

«Kurset e gjuhës frënge dhe anglishtes për mua kanë qenë të arritura më të theksuara në shkollën e mesme ekonomike. Por, mua më pëlqen gjithashtu edhe një gamë e gjerë e degëve, të cilat më mundësojnë njohuri ekonomike, të cilat më duhen për studim. Në vitin praktik mundem shumë mirë të ndërlihdë njërin me tjetrën, pra teorinë dhe praktikën.»

## Shkolla e mesme e ekonomisë

(Wirtschaftsmittelschule, WMS)

Shkolla të mesme ekonomike ofron arsimime gjithëpërfshirëse me **fokus në gjuhët** (WMS-S) dhe **informatikën** (WMS-I). Ajo çon deri në marrjen e Certifikatës federale të aftësimi profesional (EFZ) tregtare / tregtar (dega shërbime dhe administratë) si dhe maturën profesionale në ekonomi dhe shërbime, (tipi ekonomi) dhe përgatitë për ushtrimin e një profesioni tregtar ose për shkollë të lartë profesionale. Studimi në universitet është i mundshëm nëpërmjet «passarelle» dhe në shkollën e lartë pedagogjike nëpërmjet kursit paraprak në shkollën e lartë pedagogjike.


### Blerta

Shkolla e mesme profesionale, fusha profesionale komunikim dhe informim  
 «Fusha profesionale komunikim dhe informim më ofron një pasqyrë të mirë në rrugët e shumëllojshme të komunikimit dhe mëson trajtimin e rrjeteve të informimit.»

## Shkolla e mesme e informatikës

(Informatikmittelschule, IMS)

Dy karakteristika qëndrojnë në dispozicion, me të cilat mund të përfitohen dhe mësohen kompetencat profesionale, të kërkuara në tregun e punës: shkolla e mesme e informatikës **IMS-T** e drejtimit teknikë, arkitekturë, shkencat natyrore (TALS) në Qendrën e shkollimit profesional dhe të mëtejme në Rapperswil-Jona dhe shkolla e mesme **IMS-W** e drejtimit ekonomi dhe shërbime, Tipi Ekonomi dhe (WD-W) në shkollën kantonale në Brühl Sankt Gallen dhe Sargans. Me shkollën e mesme të informatikës IMS mund njëkohësisht të arrihet **matura profesionale dhe Certifikata e federale e aftësimi profesional ekspert i informatikës / eksperte e informatikës**.



### Alexandru

Fokusi në shkollën e mesme të informatikës ekonomi IMS-W  
 «Me secilin program krijohet apo lind diçka. Dhe ti ndjen kënaqësi dhe ndihesh mirë, kur gjithçka ka sukses. Me shkollën e mesme për informatikë, profesioni im i endëruar si programues bëhet realitet. Me çdo ngjarje të informatikës, i ofrohem një hap e më shpejtë caktim tim.»

Zbulo dhe përjeto më shumë në [www.maturanavigator.ch](http://www.maturanavigator.ch)

- Vizualizimi interaktiv i shtigjeve të arsimimit
- Terminët për takimet informative për profesione dhe provimet pranuese
- Informacionet mbi përshtatshmerinë dhe procedurat e pranimit
- Deklarate e nxënësve dhe nxënësve si dhe ish absolvetëve
- Broshurat dhe informacionet mbi degët e arsimimit si dhe lëndët kryesore, fushat e profesionit dhe drejtimet
- Mundësit e ardhshme për studime dhe drejtimet profesionale

Këshillime personale pranë këshillimoreve për zgjedhjen e profesionit, studime dhe karrierën profesionale të Kantonit St.Gallen ([www.bslb.sg.ch](http://www.bslb.sg.ch)) dhe të panairit të profesioneve të Zvicrës Lindore OBA.





# MATURA NAVIGATOR SG

SHKALLA TERCIARE

SHKALLA SEKONDARE II

SHKALLA SEKONDARE I

6. KLASAT FILLORE

Doktoratura në universitet/Shkollën e lartë federale të teknikës ETH

Master në universitet/Shkollën e lartë federale të teknikës ETH

Master në shkollën e lartë pedagogjike

Master në shkollën e lartë profesionale

Module shtesë në universitet/Shkollën e lartë federale të teknikës ETH

Baqelor në universitet/Shkollën e lartë federale të teknikës ETH

Baqelor në shkollën e lartë pedagogjike

Baqelor në shkollën e lartë profesionale

Pasarela

Kursi paraprak në shkollën e lartë pedagogjike

Përvoja profesionale

Gjimnazi GYM (Matura e gjimnazit)

Shkolla e mesme profesionale FMS (Matura profesionale)

Shkolla e mesme e ekonomisë WMS (Matura profesionale dhe Certifikatae federale e aftësitit profesional)

Shkolla e mesme e informatikës IMS (Matura profesionale dhe Certifikata e federale e aftësitit profesional)

Matura profesionale BM 1 (paralelisht me mësimin e profesionit me Certifikatë federale të aftësitit profesional)

Matura profesionale BM 2 (Pas mëimit të profesionit)

Mësimi i profesionit me Certifikatë federale të aftësitit profesional

Gjimnazi i ulët

3. SHKALLA E MESME

2. SHKALLA E MESME

1. SHKALLA E MESME

— Drejtpërsëdrejti, pastaj  
- - - - - Me rrugë të tërthortë

Prezantimi interaktiv i shtigjeve të arsimit nën:

[www.maturanavigator.ch](http://www.maturanavigator.ch)